



ANALIZË E PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL TË LIPJANIT 2018/2019

PRILL, 2020

COPYRIGHT © 2020. Youth Association for Human Rights (YAHR).

Youth Association for Human Rights i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit ose bartjes në asnjë formë mekanike ose elektronike, duke përfshirë fotokopjimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose tërheqjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura.

Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:

Adresa: Rruga Tahir Sinani,
14000, Lipjan,
Kosovë
Tel .: +383 (0) 44 786 414
E-mail: info.yahr@gmail.com
Web:www.ngoyahr.webbly.com

Autor: Bekim Krasniqi

Asistentë të hulumtimit: Ferdian Shala

Faqosja dhe dizajni: YAHR

Ky publikim është përgatitur nga Youth Association for Human Rights dhe përkrahur nga granti të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center”

PËRMBAJTJA:

LISTA E SHKURTESAVE.....	faqe 4
LISTA E TABELAVE DHE GRAFËVE.....	faqe 5
1.HYRJE.....	faqe 6
2. PËRMBUSHJA E AGJENDËS LEGJISLATIVE 2018/2019.....	faqe 8
3. PERFORMANCA E PARTIVE POLITIKE 2018/2019.....	faqe 9
4. PERFORMACA E KUVENDAREVE 2018/2019.....	faqe 10
5. AGJENDA E KUVENDIT KOMUNAL PËR 2020.....	faqe 12
6. PËRFUNDIME.....	faqe 12
SHTOJCA 1:	
Formulari i fletë-notimit të kuvendareve.....	faqe 14
SHËNIME:.....	faqe 15

LISTA E SHKURTESAVE:

AAK	ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
AKR	ALEANCA KOSOVA E RE
DCC	DEMOKRTASKA STRANKA
LDD	ALEANCA KOSOVA E RE
LDK	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS
LVV	LËVIZJA VETËVENDOSJE
KK	KUVENDI KOMUNAL
ORA	PARTIA ORA
PAI	PARTIA ASHKALIVE PËR INTEGRIM
PD	PARTIA E DREJTËSISË
PDAK	PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKALIVE TË KOSOVËS
PDK	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS
PSD	PARTIA SOCIAL DEMOKRATE
YAHR	YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS

LISTA E TABELAVE DHE GRAFËVE:

- Tabela 1.** E zgjedhjeve nga viti 2000 deri 2017
- Tabela 2.** Pjesëmarrja e gjinisë femërore në Kuvendin komunal të Lipjanit 2009/2017
- Tabela 3.** Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit 2015/2019
- Grafika 1:** Diskutimeve të subjekteve politike në seancat e Kuvendit Komunal të Lipjanit 2018/2019
- Tabela 4.** Diskutimeve të subjekteve politike në seancat e Kuvendit Komunal të Lipjanit 2018/2019
- Tabela 5.** Diskutimeve të kuvendarëve në seancat e Kuvendit Komunal të Lipjanit 2018/2019

1.HYRJE

Kuvendi Komunal i Lipjanit i ka 31 ulëse. Në mandatin e parë dhe të gjashtë të qeverisës, shumica e vendeve në KK i kanë takuar LDK-së. Dy vite më vonë, në zgjedhjet e dyta lokale e nxorën PDK-në si partinë më të madhe në këtë komunë. PDK-ja fitoi 14 ulëse dhe së bashku me një përfaqësues të AAK-së, qeverisën me komunën për pesë vite. Edhe në legjislaturën e tretë PDK-ja kishte shumicën e ulëseve, edhe pse e kishte një përfaqësues më pak. Numri i votave për këtë subjekt politik kishte rënë nëse e krahasojmë me zgjedhjet e vitit 2002. Humbjen më të madhe të votave në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007 e pësoi LDK-ja, votat e së cilës u përgjysmuan si pasojë e problemeve të brendshme partiake.

Në zgjedhjet e 15 Nëntorit 2009, prapë udhëheqë PDK-ja si parti më e madhe në komunën e Lipjanit me 12 kuvendarë. Në këto zgjedhje kemi një rritje të LDK-së me 9 kuvendarë si pasojë e anulimit të rezultateve në Qendrën e votimit në Shalë. Kemi një ulje të LDD-së dhe AKR-së dhe një ngritje të AAK-së. Risi në këtë legjislaturë është hyrja e PSD-së me një kuvendarë.

Ndërsa, në zgjedhjet e vitit 2013, prapë si parti me më së shumti kuvendarë, është PDK-ja me 10 kuvendarë, por e ka humbur garën për zgjedhjen e kryetarit të

komunës. Karakteristikë në zgjedhjet e vitit 2013 është se kemi një koalicioni të gjerë, i përbërë nga të gjitha partitë pjesëmarrëse në zgjedhjet e vitit 2013 (LDK-ë, AAK/LDD/IQL,AKR-ë), me përjashtim të Vetëvendosjes dhe PDK-së.

Në zgjedhjet e fundit të vitit 2017, kemi një rikthim të LDK-së si parti fituese në Komunën e Lipjanit, me 12 kuvendarë dhe kemi një rënie të PDK-së nga 10 në 6 kuvendarë, sa i kishte në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Po ashtu kemi një ngritje të LVV-së nga 2 në 3 kuvendarë. Në gjashtë legjislaturat e gjertanishme vetëm tri parti politike kanë arritur që të përfaqësohen vazhdimisht.

Përfaqësimi i komuniteteve pakicë ka ndryshuar nëpër zgjedhjet lokale, në legjislaturën e dytë (2002-2007) kanë qenë të përfaqësuar nga komunitete pakicë, dy serbë nga dy parti të ndryshme politike. Kurse në legjislaturën e tretë (2007-2009) ka qenë i përfaqësuar edhe komuniteti ashkali, i cili kishte siguruar një ulëse në Kuvend, kurse në legjislaturën e katër (2009-2013) nuk ka pasur asnjë kuvendarë nga komunitetet pakicë dhe në legjislaturën e pestë (2013-2017) dhe të gjashtë (2017-2021) kemi një kuvendarë nga komuniteti pakicë.

Tabela krahasuese 1: E zgjedhjeve nga viti 2000 deri 2017

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007		Zgjedhjet 2009		Zgjedhjet 2013		Zgjedhjet 2017	
	Nr. i Votave	Ulëse në	Nr. i Votave	Ulëse në	Nr. i Votave	Ulëse në	Nr. i Votave	Ulëse në	Nr. i Votave	Ulëse në	Nr. i Votave	Ulëse në
PDK	8317	13	10283	14	8925	13	7,926	12	8,601	10	5,338	6
LDK	10718	16	9923	13	4404	7	6,474	9	7,434	9	10,525	12
AAK	1109	2	840	1	929	1	1,036	2	-	-	2,321	3
LDD	-	-	-	-	1677	3	1,138	2	-	-	-	-
AKR	-	-	-	-	3007	5	2,652	4	2,047	2	2,193	3
ORA	-	-	-	-	746	1	477	1	-	-	-	-
PDAK	-	-	-	-	563	1	-	-	-	-	-	-
DCC	-	-	523	1	-	-	-	-	-	-	-	-
“Povratak”	-	-	391	1	-	-	-	-	-	-	-	-
PSD	-	-	-	-	-	-	847	1	643	1	-	-
Vetëvendosja	-	-	-	-	-	-	-	-	1,494	2	2,728	3
AAK/LDD/IQL	-	-	-	-	-	-	-	-	4,037	5	-	-
PD	-	-	-	-	-	-	-	-	432	1	443	1
G.I.SRPSKA	-	-	-	-	-	-	-	-	540	1	-	-
NISMA	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,656	2
PAI	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	508	1

Duke u bazuar në monitorimin e zgjedhjeve lokale dhe të punës së kuvendit komunal të Lipjanit, pjesëmarrja e gjinisë femërore në kuvendin komunal ka qenë kryesisht me një pjesëmarrje prej 10 ulëseve, të cilat janë siguruar kryesisht në bazë të kuotës së paraparë me ligj për përfaqësim në institucionet lokale. Në vitin 2009 kemi një ulëse me tepër të siguruar nga kuvendaret gra, ndërsa në vitin 2013 dhe 2014 kemi po ashtu nga 10 ulëse nga gjinia femërore. Vlen të theksohet se kuvendare të zgjedhura drejtpërdrejtë në Kuvendin Komunal në Lipjan me vota e qytetarëve nuk ka pasur

nga gjinia femërore, por që të gjitha janë zgjedhur në bazë të kuotës së përcaktuar me ligj për përfaqësim.

Kuvendaret të cilat kanë arritur të rizgjidhen në vitin 2007 nga legjislatura paraprake ishin 6 gra , në vitin 2009 janë rizgjedhur një numër më i madhe i kuvendareve në 9 gra. Në vitin 2013 kanë arritur të rizgjidhen vetëm 3 kuvendare për përfaqësim në Kuvendin Komunal të Lipjanit, ndërsa në vitin 2017 kemi vetëm një grua që ka arritur të rizgjidhet si përfaqësuese e qytetarëve.

Tabela krahasuese 2: Pjesëmarrja e gjinisë femërore në Kuvendin komunal të Lipjanit 2009/2017

PJESËMARRJA E GJINISË FEMËRORE NË KUVENDIN KOMUNAL NË LIPJAN																							
Nr. ulëseve në asamble				Nr. femrave në asamble								Nr. kuvendarëve (femra) të zgjedhura pa kuotën e paraparë me ligje				Nr. Kuvendarëve të rizgjedhur							
2017	2013	2009	2007	2017	%	2013	%	2009	%	2007	%	2017	2013	2009	2007	2017		2013		2009		2007	
31	31	31	31	10	32.25	10	32.25	11	35.48	10	32.25	0	0	0	0	M	F	M	F	M	F	M	F
																8	1	3	3	10	9	5	6

2. PËRMBUSHJA E AGJENDËS LEGJISLATIVE 2018/2019

Sipas analizës krahasuese të bërë nga monitoruesit e organizatës YAHR, të cilët në mënyre eksplicite janë marrë vetëm me punën e kuvendi komunal të Lipjanit. Në vitin 2018 kemi një ulje të numrit të shqyrtimeve të

raporteve nga ana e kuvendareve të paraqitura nga ekzekutivi komunal, ku kemi vetëm tri raporte të shqyrtuara, ndërsa në vitin 2019 kemi një ngritje në 11 raporte të shqyrtuara nga ana e Kuvendit Komunal.

Tabela krahasuese 3: Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit 2015/2019

Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit											
Raporte të shqyrtuara				Rregullore dhe plane komunale të miratuara				Vendime komunale të miratuara			
2015	2016	2018	2019	2015	2016	2018	2019	2015	2016	2018	2019
5	10	3	11	5	7	5	11	24	41	26	43

Rregullore dhe planet e miratuar në Kuvendin Komunal të Lipjanit nga viti në vit kanë pasur ndryshime. Në vitin 2018 kemi pasur vetëm 5 rregullore dhe plane komunale të shqyrtuara , ndërsa vitin 2019 është viti në të cilin komuna e Lipjanit ka arritur më së shumti që të miratoj dhe atë 11 plane dhe rregullore.

Në krahasim me raportet dhe me rregulloret e Kuvendit Komunal, kemi një zhvillim më të mirë sa i përket vendimeve komunal të miratuara, në vitin 2018 kuvendaret lipjanas kanë arritur që ti miratojnë 26 vendime komunale, ndërsa në vitin 2019 janë miratuar 43 vendime dhe që konsiderohet si viti me i mirë punës së kuvendit komunal.

3. PERFORMANCA E PARTIVE POLITIKE 2018/2019

Në bazë të analizës krahasuese të diskutimeve të partive politike përgjatë viteve 2018 dhe 2019, të cilat në mënyrë të detajuar janë paraqitur edhe në tabelën dhe në grafikun e mëposhtëm. Subjekti politikë i cili ka marr pjesë me më shumti në diskutime për gjatë seancave plenare në Kuvendin Komunal gjatë viteve 2018/2019, është Partia Demokratike e Kosovës, me 217 diskutime, pastaj radhitet partia tjetër opozitare e cila është Lëvizja Vetëvendosje me 124 diskutime, ndërsa partia e tretë

për nga radhitja me pjesëmarrje në diskutime është Lidhja Demokratike Kosovës e cila njëherësh është edhe në pozitën udhëheqëse në ekzekutivin e Komunës së Lipjanit me 75 diskutime , partia e katërt është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 63 diskutime, Aleanca Kosova e Re me 41 diskutime, Partia e Drejtësisë me 25 diskutime, Nisma me 22 diskutime dhe Partia e Ashkalive për Integrim me vetëm 3 diskutime.

Grafika 1: Diskutimeve të subjekteve politike në seancat e Kuvendit Komunal të Lipjanit 2018/2019




Tabela krahasuese 4: Diskutimeve të subjekteve politike në seancat e Kuvendit Komunal të Lipjanit 2018/2019

KOMUNA E LIPJANIT	Diskutimet e gjashtëmuajorit të parë 2018	Diskutimet e gjashtëmuajorit të dytë 2018	Diskutimet e gjashtëmuajorit të parë 2019	Diskutimet e gjashtëmuajorit të dytë 2019	Gjithsej
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	24	19	16	16	75
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	67	51	52	47	217
LËVIZJA VETËVENDOSJE	39	34	31	20	124
ALEANCA KOSOVA E RE	9	13	13	6	41
ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS	17	22	12	12	63
NISMA	4	6	6	6	22
PARTIA E DREJTËSISË	7	4	6	8	25
PARTIA ASHKALIVE PËR INTEGRIM	0	0	2	1	3

4. PERFORMACA E KUVENDAREVE 2018/2019

Në bazë të vlerësimit të bërë nga puna e drejtpërdrejtë në seanca plenare për gjatë viteve 2018/2019, del se kuvendari me më së shumti pjesëmarrje në diskutime është Ramiz Qeriqi nga subjekti politik i PDK-së, i cili ka arritur që ti grumbulloj 351 pikë, ndërsa kuvendari i dytë për nga angazhimi ose vlerësimi është Lulzim Rustemi nga PDK-ë me 339 pikë të grumbulluara, pastaj vjen kuvendari i subjektit politik LVV-së, Selatin Retkoceri i cili ka arritur të mbledh gjithsej 284 pikë, në pozitën e katërt për nga pikët e grumbulluara është Nazmi Krasniqi kuvendar nga PDK-ja me gjithsej 237 pikë dhe në vendin e pestë radhitet kuvendari i subjektit politik nga AKR-ja, Afrim Miftari me gjithsej 231 pikë.

Kuvendaret më pak aktiv përgjatë dy viteve 2018/2019 në bazë të vlerësimeve për pjesëmarrje në diskutime në mbledhjet e Kuvendit Komunal të Lipjanit, janë: Naim Stullca kuvendarë nga LDK-ja, i cili nuk ka arritur të marrë as një pikë, të cilin e ka zëvendësuar ish kuvendarin Arton Retkocerin, në pjesën e dytë të vitit 2018, ndërsa në vendin e dytë për nga pasiviteti e zë Arif Miftari po ashtu kuvendari nga LDK-ja me 17 pikë (i cili e ka zëvendësuar kuvendarin Diamant Bytyqin), ndërsa Naim Jahiri kuvendarë nga LDK-ja, ka arritur që të grumbulloje gjithsej 18 pikë, në vendin e 5 radhitet kuvendari Hajdin Bytyqi nga AKR-ja me 27 pikë.

Tabela krahasuese 5: Diskutimeve të kuvendreve në seancat e Kuvendit Komunal të Lipjanit 2018/2019

KOMUNA E LIPJANIT		Pikët e gjashtëmujori t të parë 2018	Pikët e gjashtëmujori i dytë 2018	Gjithsej 2018	Pikët e gjashtëmujori i parë 2018	Pikët e gjashtëmujori i dytë 2018	Gjithsej 2019	Gjithsej 2018/2019
Kuvendarët	Subjekti politik							
RAMIZ QERIQI	PDK	109	82	191	50	110	160	351
LULZIM RRUSTEMI	PDK	132	89	221	109	9	118	339
SELATIN RETKOCERI / ALBAN SALIHU	LVV	112	85	197	49	38	87	284
NAZMI KRASNIQI	PDK	62	66	128	34	75	109	237
AFRIM MIFTARI	AKR	34	48	82	0	149	149	231
LUMTURIJE BYTYQI HASANI	PDK	74	62	136	22	65	87	223
SHKELZEN BISLIMI	LVV	62	57	119	101	0	101	220
ALBULENA KELMENDI	LVV	74	69	143	52	18	70	213
UKË KRYEZIU	AAK	64	71	135	37	31	68	203
ARGJENT TASHOLLI	PDK	42	38	80	42	64	106	186
EGZONA BYTYQI	PDK	9	32	41	54	56	110	151
MAJLINDA SYLEJMANI	LDK	6	10	16	116	12	128	144
LINDA SHAHINI / FATIME KRASNIQI	LDK	60	0	60	15	39	54	114
BASHKIM BUDAKOVA	AAK	14	44	58	37	4	41	99
ARBEN SALIHU	PDK	33	26	59	18	12	30	89
MEHMETALI KRASNIQI	LDK	0	0	0	82	0	82	82
GANIMETE QERIQI	AAK	14	15	29	0	39	39	68
HYRA BYTYÇI	LDK	29	38	67	0	0	0	67
FEHMI REXHEPI	PAI	15	5	20		47	47	67
EGZONA FAZLIJA	NISMA	14	12	26	34	0	34	60
ANILA REÇICA LLUGIQI	LDK	14	8	22	10	9	19	41
NEHAT TËRPEZA	LDK	21	8	29	11	0	11	40
FADIL SOPA	LDK	0	0	0	0	37	37	37
RAMADUSH TASHOLLI	LDK	0	0	0	32	5	37	37
SAFETE AMERLLAHU	AKR	9	4	13	24	0	24	37
MANUSH SHAMOLLI	NISMA	0	0	0	17	18	35	35
HAJDIN BYTYQI	AKR	0	0	0	0	27	27	27
NAIM JAHIRI	LDK	9	9	18	0	0	0	18
DIAMANT BYTYQI / ARIF MIFTARI	LDK	0	0	0	0	17	17	17
NAIM STULLCA / ARTON RETKOCERI	LDK	0	0	0	0	0	0	0

5. AGJENDA E KUVENDIT KOMUNAL PËR 2020

Në bazë të rrethanave të cilat janë krijuar nga pandemia e virusit Covid-19, i cili e ka pa mundur zhvillimin e jetese normale në të gjithë vendin. Andaj kjo në mënyre eksplicite ka ndërhyra edhe në zhvillimin e punimeve të kuvendit komunal për vitin 2020, si pasoje e kësaj pandemie agjenda e kuvendit komunal të Lipjanit, por edhe të komunave të tjera në Kosovë, rrezikon që për këtë vite kalendarikë të dështoj pasi që masat të cilat

janë ndërmarrë nga ana e ekzekutivit e pa mundësojnë zhvillimin e një seance normale të kuvendit.

Ende nuk është parë ndonjë iniciativë e ri funksionalizimit të punës së kuvendit komunal as nga ana e vete kuvendit e as nga ana e ekzekutivit, pasi që fokusimi tani për tani është tek luftimi i pandemisë e cila po e rrezikon jetën normale të qytetareve.

6. PËRFUNDIME

Kjo analizë ka pasur për qëllim që të bëjë krahasimin e punës së kuvendit komunal të Lipjanit për gjatë vitit 2018/2019, nga monitoruesit e organizatës YAHR, të cilët kanë bërë monitorimin e punës së kuvendit që nga viti 2009. Duke analizuar zgjedhjet komunale në komunën e Lipjanit që nga viti 2002 e deri në vitin 2017 vërejmë se kuvendare të zgjedhura nga vota e qytetareve të komunës së Lipjanit nuk ka pasur, përveç me ana të ligjit për kuotën gjinore të përfaqësimit nëpër kuvende komunale.

Këtu mundët të konstatojmë se ende në komunën e Lipjanit, nuk është arritur që pozita e gruas të ngritet në aspektin e vetëdijes qytetare e cila do të mundët të përfaqësonte në mënyrë të dinjiteteshme interesat e qytetarëve, andaj ne rekomandojmë që komuna e Lipjanit ti kushtoj më shumë rëndësi të veçantë në

ngritjen e pozitës së gruas në pozitë drejtuese të ekzekutivit, siç janë drejtorit komunal ku nëpër mes tyre do të mundet të promovohet puna e gruas tek qytetaret.

Në baze ta analizës krahasuese të agjendës së kuvendit komunal të Lipjanit, e cila përfshihet që nga viti 2015 deri në vitin 2019, atëherë në kemi vërejtur se numri i raporteve të shqyrtuara është jo i kënaqshëm pasi që në një viti janë shqyrtuar 5 raporte ndërsa në një tjetër 11, pra kemi një disproporcanc të shqyrtimit të raporteve nga ana e ekzekutivit. Një ashtu mundemi të deklarojmë se edhe numri i rregulloreve dhe planeve të veprimit nuk është i kënaqshëm pasi që edhe këtu vit vërejmë një numër të vogël të rregulloreve dhe planeve të veprimit të cilat janë miratuar në kuvendin komunal të Lipjanit, ky numër nuk e kalon numrin 11 të rregulloreve dhe planeve të veprimit.

Vlen të theksohet se për dallimi nga numri i raporteve dhe rregulloreve të kuvendit komunal të Lipjanit vërejmë se numri i vendimeve të kuvendit komunal është në një numër më të madh të vendimeve të cilat janë miratuar, pra këtu numri i vendimeve përgjatë viteve arrin në 43 vendime komunale.

Sa i përket diskutimeve të partive politike përgjatë viteve 2018/2019 në bazë të analizës krahasuese të cilën e kanë bërë monitoruesit e organizatës YAHR mund të konstatojmë se të gjitha partitë politika janë përfshirë në diskutimet e kuvendit komunal të Lipjanit.

Analizimi i performances së kuvendareve në kuvendin komunal të Lipjanit është bërë në mënyrë të detajuar dhe të specifikuar në vlerësimin e të gjithë kuvendareve në bazë të aktivitetit të tyre përgjatë diskutimeve në seancat e Kuvendit. Këtu mundemi të konstatojmë se një numër i madhe i kuvendareve është përfshirë në debate diskutime të këtij kuvendi, duke filluar nga ngritja e një çështje e deri tek diskutimet për vendimet të ekzekutivit, pra këtu mund të konstatojmë se është

një numër i konsiderueshëm i kuvendareve të cilët përfshihen në diskutim të seancave të kuvendit komunal..

Ndërsa sa i përket përmbushjes së agjendës së kuvendit komunal për vitin 2020, ka hasur në vështirësi si pasojë e përhapjes së pandemisë me Covid-19 e cila ka pezulluar zhvillimet e punës normale të kuvendit, por edhe të vete funksionimit të jetës normale në Kosovë dhe që rrezikon që të dështoj në zhvillimin e punës së kuvendit komunal për vitin 2020. Këtu ne si organizatë kemi organizuar takime online me kuvendarë dhe me ekzekutivin e Komunës së Lipjanit, dhe kemi propozuar që ekzekutivi në bashkëpunim me kuvendin komunal të fillojnë përgatitjet e zhvillimit të punës së kuvendit në platformën online, të mbajtjes së seancave të kuvendit komunal ose të shikohen edhe alternativa të tjera, siç është salla ose amfiteatër ku do të mund të respektohet distanca prej 1.5 metra dhe në këtë mënyrë të arrihet funksionalizimi i punesë së kuvendit komunal.


SHTOJCA 2: infografikat

Analizë e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit gjatë 2018 /2019

Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit 2018/2019




Diskutimet e subjekteve politike në seancat e Kuvendit Komunal të Lipjanit 2018/2019



Ky publikim është përgatitur nga Youth Association for Human Rights dhe përkrahur nga granti të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center”

Top 5 me aktive e kuvendareve në seancat e Kuvendit Komunal të Lipjanit gjatë 2018/2019



Top 5 më pak aktive e kuvendareve në seancat e Kuvendit Komunal të Lipjanit gjatë 2018/2019



NGO Youth Association for Human Rights (YAHR) is a non-governmental and non-profit organization.

The mission of the NGO is to protect human rights of youth, to support youth with different activities and to promote democracy and tolerance between youth of all ethnicities living in Kosovo.

